



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr: 04-351/02-91589

Dt. 20.08.2026

Prizren

DREJTORATI PËR URBANIZËM dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR, me kërkesën e **Kujtim Sylaj** nga Prizreni në bazë të nenit 3 paragrafi 1 pikat 1.1, 1.4, 1.5 nën-pika 1.5.4, 1.16, 1.17, 1.20, 1.24, e lidhur me nenin 5 paragrafi 1 pika 1.2 si dhe nenin 14 paragrafi 1 pika 1.2 si dhe në lidhje me nenin 15 pika 1.1 dhe nenit 19 pika 2. të Ligjit për ndërtim nr.04/L-110, nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të neneve 13, 14, 44, 45, 46, 47 e në lidhje me nenin 125 dhe 127 të LPPA-së nr. 05/L-031 dhe sipas vendimit për miratimin e HZK për periudhën 2022 nr.001-011-48192 të dt. 31.03.2022 merr këtë:

VENDIM

- I. **LEJOHET**: pronarit Kujtim Sulaj në zhvillimin e punimeve – renovimin e një pjese të objektit dhe mbindërtimin e katit të pjesës tjetër të objektit. Etazhiteti i objektit egzistues është P+Nk. në etazhitet P+1+Nk. të një pjese të objektit në njësinë kadastrale P-71813068-01137-49 ZK Prizren në rrugën “ Ibrahim Rugova ” Prizren.
- II. Investitori duhet të përmbahet Vendimit të IKMM-së me nr. 153/2026 të dt. 15.07.2026
- III. Dokumentacioni teknik e mban titullin e tipit të veçantë dhe është punuar nga byroja projektuese “ EK architects “ -Prizren.
- IV. Është miratuar taksa komunale në shumën prej 1051.36Euro.
- V. Gjatë implementimit të projektit nuk lejohet kurrfarë ndryshimi në gabarit dhe në etazhitet të një pjese të objektit.
- VI. Ditën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë inspektionin e ndërtimtarisë në afat prej 8 ditësh.
- VII. Ky aktvendim pushon të vlejë në rast se me punë nuk fillohet brenda afatit prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh duke llogaritur nga dita e marrjes së të njëjtës.

VIII. Pas kryerjes së punimeve shfrytëzuesi obligohet të pastroj vend punishten.

A r s y e t i m

Nga dokumentacioni teknik si dhe të shtojcave tjera të prezantuara së bashku me kërkesë vërtetohet se:

Që me procedurën paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik nga ana e bashkëpunëtorit profesional, të Komunës së Prizrenit.

Duke shqyrtuar kërkesën e investitorit si dhe në kuptim të dispozitave të Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve të KK Prizren, është konstatuar se janë plotësuar kushtet për dhënien e lejes për renovimin e një pjese të objektit dhe mbindërtimin e katit të pjesës tjetër të objektit. Etazhiteti i objektit egzistues është P+Nk. në etazhitet P+1+Nk. të një pjese të objektit në njësinë kadastrale P-71813068-01137-49 ZK Prizren në rrugën “ Ibrahim Rugova ” Prizren.

Nga se u tha më lartë u murr aktvendimi si në dispozitiv.

KËSHILLA UDHËZUESE JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor , përmes këtij organi.


Bashkëpunëtor profesional:



Afërdita Mormorina, inxh.dipl.ark.



DREJTORI



Florent Ukaj, ecc.dip.